



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 54 të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe të Rregullës Zgjedhore 07/2013 për Vëzhguesit e Zgjedhjeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 02.10.2021, merr këtë:

VENDIM

për akreditim të grupit të vëzhguesve të "Lista e Ashkalive" (LA)

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim, për akreditimin e grupit të Vëzhguesve të Iniciativës Qytetare "Lista e Ashkalive" me njëqindnjëzetepesë (125) vëzhgues afatshkurtër, për vëzhgimin e ditës së zgjedhjeve për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më 17 tetor 2021.
- II. Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim është e obliguar ta njoftojë Iniciativën Qytetare "Lista e Ashkalive" me obligimet e organizatave të akredituara dhe vëzhguesve të tyre që rrjedhin nga neni 4 i Rregullës Zgjedhore 07/2013 për Vëzhguesit e Zgjedhjeve.
- III. Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim është e obliguar ta njoftojë Iniciativën Qytetare "Lista e Ashkalive" për marrjen e këtij vendimi.
- IV. Lista e vëzhguesve të Iniciativës Qytetare "Lista e Ashkalive" është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi



Këshillë juridike: Brenda 24 orëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, të gjithë personat që kanë interes ligjor kanë të drejtë ankese në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa – PZAP.